



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 434/5 prot.

Tiranë, më 2.11.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 698, datë 15.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gjergji Tako
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 18.10.2023, është njoftuar vendimi përfundimtar nr. 698, datë 15.9.2023, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gjergji Tako, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Së bashku me vendimin përfundimtar, si pjesë e akteve në dosje, Komisioni ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe *vendimin e ndërmjetëm* nr. 9 të Komisionit, nr. 464 akti, datë 17.6.2022, me anë të të cilit ka vendosur: [...] *pezullimin nga detyra të z. Gjergji Tako, për një periudhë njëvjeçare me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës [...].*

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, si përfaqësues i interesit publik, neni F i aneksit të Kushtetutës dhe neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin përfundimtar të marrë nga Komisioni për subjektet e rivlerësimit, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 698, të datës 15.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë. Referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

3. ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Gjergji Tako¹*”, ka referuar për subjektin se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje të pasurive*; (iv) *ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

4. DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në të dyja raportet mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit,² i ka referuar Komisionit: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

5. KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Gjergji Tako.

6. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

6.1. Për vlerësimin e pasurisë. [...] *Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në përfundimin se, pavarësisht përdorimit të automjeteve pa leje qarkullimi, përbën veprim në kundërshtim me etikën e prokurorit, duke marrë në konsideratë faktin se nga hetimi administrativ i pasurisë rezulton se subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako ndodhet në kushtet e deklaratimit të saktë dhe me burime të ligjshme, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlerëson se ky fakt nuk përbën shkak për shkarkim nga detyra, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

6.2. Për kontrollin e figurës. [...] *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

6.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] *Trupi gjykues konstatoi se subjekti ka shfaqur në mënyrë të përsëritur mangësi në ndjekjen logjike të hetimit sipas kërkesave ligjore në arsyetimin e vendimeve, në analizën e elementeve të figurës së veprës penale, në analizimin e jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe në analizimin e*

¹ Raporti me nr. ***/** prot., datë **.12.2018, i ILDKPKI-së.

² Shkresë nr.*** prot., datë **.11.2017, e DSIK-së, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. **, datë ***.1.2021. Raporti i dytë, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë **.11.2021, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. **, datë ***.2.2022.

³ Raporti nr. *** prot., datë **.7.2020, i KLP-së.

*legjislacionit përkatës në rastet kur dispozita e Kodit Penal ishte blankete (e bardhë)... Pas analizimit të detajuar të dosjeve të administruara qoftë në kuadrin e vlerësimit profesional, qoftë në kuadrin e vlerësimit të figurës, Komisioni konstatoi mangësi profesionale, të cilat mund të plotësoheshin nëpërmjet ndjekjes së programit të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës... Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. **, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit [...].*

7. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1, dhe të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

8. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, në momentin procedural të njoftimit të vendimit të Komisionit, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet përfundimtare të dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij, në të cilën janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

11. Sa më sipër, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit përfundimtar nr. 698, datë 15.9.2023, çmon se përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar nr. 698/2023, të Komisionit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tij.

II.A Vlerësimi lidhur me aspekte të zbatimit të ligjit

12. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në çështjen objekt shqyrtimi, shtrohen paraprakisht aspekte të zbatimit të ligjit, sa vijon:

12.1. Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me shkakun ligjor të “*cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë*”, ka vendosur standardin se është plotësisht e përshtatshme që institucionet e rivlerësimit të japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 5 e tij, autorizon në mënyrë specifike një masë të tillë disiplinore, në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces. *Për sa i përket matjes së cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*, jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur standardin që institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm te publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë te qytetarët. Ka një sërë sjelljesh, nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimt në situatën e konfliktit të interesit, paaftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave private përpara interesit publik etj.

12.2. Për sa i përket *vlerësimit të aftësisë për prokurorët*, në kuptim të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, dhe praktikës gjyqësore, një ndër treguesit për aftësinë për të hetuar dhe ngritur akuzën publike janë edhe njohuritë ligjore, të cilat pasqyrohen në aktin procedural të përpiluar nga prokurori, konkretisht kërkesa për gjykim, vendim mosfillimi apo vendim pushimi të procedimit penal.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A Për vlerësimin e aftësive profesionale

13. Rezulton se hetimi i Komisionit, lidhur me kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, është bazuar në sa vijon: **(i)** raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; **(ii)** ankesat e paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kallëzimet penale të depozituara në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore; **(iii)** denoncimet e publikut; **(iv)** dosjet penale të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas vendimeve të ndërmjetme të Komisionit, të datave 4.5.2022 dhe 10.5.2022.

14. Komisioni, pas shqyrtimit të *Raportit të aftësive profesionale*, të përgatitur nga KLP-ja, dosjeve penale të administruara sipas vendimeve të ndërmjetme të Komisionit, të datave **5.2022 dhe **5.2022, verifikimit të ankesave të paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kallëzimet penale të depozituara në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, shqyrtimit të denoncimeve të depozituara në Komision, në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit*”, datë 6.4.2022 dhe në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, datë 3.6.2022, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime dhe, në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale, pasi ka shqyrtuar përgjigjet e subjektit, ka marrë vendimin e ndërmjetëm nr. 9, nr. 464 akti, datë 17.6.2022, për çështjet si vijon:

15. *Lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014*, kundër të pandehurve *** (***) dhe *** ***, akuzuar respektivisht “Për kanosje për shkak të detyrës” dhe “Deklarim i rremë përpara Oficerit të Policisë Gjyqësore”. Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht për të tria kriteret e rivlerësimit*”, ka konstatuar se kjo kërkesë: (i) nuk përmban

elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale dhe (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit, fakte për të cilat i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

15.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet⁴ në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

15.2. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

16. *Për vendimin e mosfillimit të procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, viti 2014*, lidhur me vdekjen e shtetasit *** ***, dhe akteve të kësaj dosje penale, Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në pyetje bashkëshorten e viktimës, me qëllim sqarimin e shkaqeve që kanë çuar në vetëfljimin e viktimës, fakt për të cilin i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

16.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet⁵ në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse për Komisionin dhe, përfundimisht, Komisioni iu ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

16.2. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

16.2.1. Në *Raportin e aftësive profesionale*, të përgatitur nga KLP-ja, ndër të tjera, është referuar si shkelje procedurale fakti se vendimi i mosfillimit nuk është marrë brenda afatit 30-ditor parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i Prokurorit të Përgjithshëm.

17. Për procedimin penal nr. *, datë **.8.2013**, në ngarkim të shtetaseve *** ***, dhe *** ***, për dyshime rreth konsumimit të veprës penale “Ekspertim i rremë”,⁶ parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, mbi kallëzimin e shtetasit *** ***. Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”, lidhur me procedimin, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka kryer

⁴ Në pikën 13 të prapësimeve, dokumenti “*Përgjigje finale Vetting*”, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...Analiza e natyrës teorike/doktrinare e katër elementeve të figurës së veprës penale, sikurse parashtrohet në materialet akademike apo ato arsimore, nevojitet jo në çdo rast, por kur rasti ka vështirësi në provim apo interpretim në një apo disa nga elementet e figurës së veprës penale... mendoj se nuk ka detyrim të natyrës absolute të neni 331 i K. Pr. Penale për parashtrim teorik të 4 elementeve të figurës të veprës penale... aktet janë konfirmuar nga zv/Drejtuasi dhe Drejtuesi i Prokurorisë që, për kohën, kishin fuqi të plotë shfuqizuese dhe vendimmarrëse. Ata nuk kanë lënë asnjë shënim negativ apo me rezervë, çka tregon se parametrat e dosjes kanë qenë brenda praktikave më të mira të kohës...”.

⁵ Në pikën 14 të prapësimeve, dokumenti “*Përgjigje finale Vetting*”, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...ka pyetur të nipërit e të ndjerit *** ***, të cilët janë rrethi më i afërt menjëherë pas bashkëshortes... Vendimi i mosfillimit i është përcjellë znj. *** ***, bashkëshortes së të ndjerit, e cila nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik në të drejtën e saj për të kërkuar sqarime apo hetime të mëtejshme”.

⁶ Shtetasi *** ***, ka qenë në një proces gjyqësor civil, me objekt “Detyrimin për shpërblimin e dëmit”, në të cilin Gjykata ka thirrur si ekspert vlerësues të pasurive të paluajtshme ing. *** ***, dhe ekspert kontabël *** ***, ku në përfundim të gjykimit, Gjykata ka dhënë vendim, i cili, sipas pretendimeve të kallëzuesit, është i padrejtë, pasi është bazuar në një akt-ekspertim të rremë të kryer nga ekspertet, të cilat, referuar aktit, kanë zmadhuar tri herë masën e përfitimit në lidhje me sipërfaqen takuese të ndërgjyqësve, duke dhënë një konkluzion të pabazuar në provat shkresore që administrohen në dosje.

veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e rezultateve të aktit të ekspertimit përpara se të merrte vendimin e mosfillimit; (ii) ka marrë vendimin e datës **.5.2012, për mosfillimin e procedimit penal në kundërshtim me nenin 290, pika 1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës.

17.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet⁷ në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse për Komisionin dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

17.2. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se subjekti, edhe në këtë rast, ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016.

18. Për vendimin e pushimit, datë **.10.2015, të procedimit penal nr. *, të vitit 2014,** në ngarkim të shtetasit *** ***, për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, Komisioni me aktin, “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar qartësisht dhe në mënyrë të kuptueshme elementet e figurës së veprës penale, për të cilin i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

18.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet⁸ në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

18.2. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3, të nenit 73⁹, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

19. Lidhur me procedimin penal nr. *, të vitit 2013,** në ngarkim të të pandehurve *** ***, dhe *** ***, për veprat penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe “Mbajtje pa leje të armëve luftarake ose municioneve”, të parashikuara nga nenet 283/1 dhe 278/2, dhe 3 të Kodit Penal. Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka përfshirë në dokumentin e njoftimit të akuzës së të pandehurit datë **.2.2014, akuzën për veprën penale “Mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, sipas referimit të policisë; (ii) akti “Për plotësimin e akuzës”, datë **.3.2014, ndaj shtetasit *** ***, për veprën penale “Mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal, është hartuar pa kryer veprime hetimore shtesë; (iii) kërkesa për gjykimin e procedimit penal nuk

⁷ Në pikën 26 të prapësimeve, parashtrime për pikën 3.19, dokumenti “*Përgjigje finale Vetting*”, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...I qëndroj arsytimit të qartë shterues për bindjet e mia dhe shtoj se pushimi ka ndodhur për pikën “nuk parashikohet nga Ligji si vepër penale” dhe pasi palët njoftuar rregullisht, nuk ka patur ankim apo shfuqizim, pra përsëri nuk ka cenim të besimit të Drejtësisë. pasi përcaktimet e mia bëjnë pjesë në një mesatare të pranueshme mendimi juridik”.

⁸ Në pikën 15 të prapësimeve, dokumenti “*Përgjigje finale Vetting*”, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...Unë si prokuror kam qenë dhe jam i qëndrimit që vendimet apo akte të ngjashme të Prokurorive ... duhet të strukturohen sipas formimit të njerëzve të thjeshtë... me pak fjalë, dua të them se një i pandehur me formim jojuridik apo dhe me shkallë të reduktuara të arsimit të përgjithshëm, nuk do të qartësohej më shumë për problemet ku ka qenë i përfshirë, kur tek vendimi që i takon situatës së tij lexon elementet teorike/doktrinale të së drejtës penale, por përkundrazi do të ndihej më i paqartë dhe do të kërkonte detyrimisht të adresohet te specialistët e fushës... unë, si subjekt rivlerësimi, në këtë rast, i kam kushtuar rëndësi njërit element të figurës së veprës penale për ta përshkruar, pikërisht sepse në këtë rast ka nevojë për interpretim. Elementi që unë kam përshkruar, analizuar dhe arsytuar, është shkaku vendimtar, i cili në anën objektive është i domosdoshëm që të ekzistojë”.

⁹ Neni 73, i ligjit nr. 96/2016, parashikon se: “...3. **Aspekti i arsytimit ligjor** të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të Prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të Prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit...”.

përmban analizën e individualizimit të përgjegjësive penale për secilin të pandehur, si dhe analizën e elementeve të figurës për veprat penale që akuzohen; (iv) vendimi i datës **.2.2014 për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk i është njoftuar të pandehurit dhe është marrë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale (neni 324, pika 2), për të cilat Komisioni i ka kërkuar subjektit të jap shpjegimet e tij.

19.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet¹⁰, në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar¹¹ gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

19.2. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

20. *Lidhur me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013*, në ngarkim të shtetasit *** ***, akuzuar për veprën penale “Vjedhja”, të parashikuar nga neni 134/1, i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”, ka konstatuar se kjo kërkesë për gjykim nuk përmban vlerësimin e prokurorit mbi faktin penal dhe analizën e elementeve të figurës së veprës penale në ngarkim të pandehurit, fakt për të cilin i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

20.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet¹² në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

20.2. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteri i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

21. *Për procedimin penal datë **.5.2019, mbi kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2019.* Me vendimin për mosfillimin e procedimit penal, datë **.5.2019, lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2019, subjekti ka vendosur mosfillimin mbi kallëzimin penal të shtetasit *** ***, për veprën penale të “Ekspertimit të rremë” ndaj shtetasës *** ***, me detyrë eksperte inxhinierë arkitekthe. Ky shtetas ka qenë palë në një proces gjyqësor civil në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku gjatë procesit, gjykata ka caktuar si eksperte shtetasen *** ***. Sipas kallëzuesit, ekspertja nuk ka pasqyruar në mënyrë të drejtë faktet dhe rrethanat objekt ekspertimi dhe, për këtë arsye, ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale të “Ekspertimit të rremë”, të parashikuar nga neni 309, i Kodit Penal.

21.1. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës **.5.2019, bazuar në nenin 290/1/ç, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e materialit kallëzues nr. ***, datë **.5.2019, ku arsyeton se: [...] *Kjo çështje është ende në gjykim. Fillimisht, një palë duhet t'i*

¹⁰ Në pikën 16 të prapësimeve, dokumenti “*Përgjigje finale Vetting*”, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...me plotësimin e akuzës të datës **.3.2014, thjeshtë kam rregulluar një gabim timin teknik të mëparshëm për të shtuar nenin 278/2 të K.P., në akuzën e datës **.2.2014, pasi provat ishin që në atë datë për konsumimin e nenit 278/2. Gjithashtu, për sa kohë kjo dosje penale nuk ka asnjë problematikë serioze (shpërblim në dëm të shtetit për burgim të padrejtë, lehtësim alarmant i pozitave të pandehurve), nuk ka cenim të besimit të publikut, pasi drejtësia është dhëna pa pasojë...”.

¹¹ Përveç pikës (iv) të aktit *Rezultate të hetimit kryesisht...*

¹² Në pikën 17 të prapësimeve, dokumenti “*Përgjigje finale Vetting*”, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... i qëndroj arsyetimeve të mëparshme për shtjellimin doktrinal në akte kur janë dosje dhe ngjarje të qarta... Duke u kthyer te rasti konkret, ngjarja është tejet e thjeshtë, tejet në flagrancë, është kapje aty për aty e autorit të vjedhjes, çka e kthen plotësisht në formalizëm të panevojshëm (vetëm për këtë rast apo të ngjashëm në parametra) shtjellimin teorik të elementeve të figurës së veprës penale... Drejtësia është dhënë pa pasojë. Nuk rezulton niveli për të patur cenim të besimit të publiku...”.

paraqesë kundërshtimet e tij ndaj një ekspertimi përpara Gjykatës ku po zhvillohet gjykimi dhe më pas në Gjykatën e Apelit...Vetëm pasi sistemi gjyqësor shprehet kundër përfundimeve të ekspertit me vendim të formës së prerë, atëherë mund të diskutohet nëse gabimet e ekspertit janë ose jo ekspertim i rremë... Sa kohë nuk ka një vendim të formës së prerë të sistemit gjyqësor, nuk mund të regjistrohet procedim penal në momentin e tanishëm procedural [...].

21.2. Kundër vendimit të mosfillimit të prokurorit Gjergji Tako, kallëzuesi *** ** ka bërë ankim në gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** Regj. Them., datë **.10.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Nga informacioni i marrë nga Gjykata e Apelit Tiranë¹³ rezulton se kundër këtij vendimi kallëzuesi ka bërë ankim dhe, deri në datën 9.2.2022, çështja nuk është planifikuar për gjykim.

21.3. Pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shtetasi *** ** ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda kundër subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal. Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda i ka përcjellë për kompetencë kallëzimin e shtetasit *** ** Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës. Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, *** **, me vendimin e datës **.12.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***/2019, me arsyetimin se prokurori Gjergji Tako, duke qenë prokuror i çështjes, ka qenë personi kompetent i ngarkuar me ligj, për hetimin dhe vendimmarrjen e mësipërme dhe nuk mund të përbëjë element të figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”.

21.4. Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit kryesisht...”, ka konstatuar se: (i) arsyetimi i subjektit në vendimin datë **.5.2019 se [...] çështja është duke u gjykuar nga gjykata civile dhe për çdo pretendim kallëzuesi duhet t’i drejtohej kësaj gjykate dhe vetëm pasi gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë kundër përfundimeve të aktit të ekspertimit, mund të diskutohet nëse gabimet e ekspertit janë ose jo ekspertim i rremë [...], nuk është i mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale; (ii) vendimi “Për mosfillimin e procedimit penal”, i datës **.5.2019, nuk është i mbështetur në nenin 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale; (iii) subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për të verifikuar nëse rezultatet e aktit të ekspertimit janë ose jo të rreme, për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës.

21.5. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet¹⁴ në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “Rezultate të hetimit kryesisht...”.

21.6. Komisioneri Publik vlerëson se, përveç mangësive të konstatuara më lart në këtë ankim, subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer

¹³ Shkresa nr. ***/** prot., datë **.2.2022.

¹⁴ Në pikën 26 të prapësimeve, parashtrime për 4.36, në dokumentin *përgjigje finale Vetting*, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...Ne lidhje me situatën e ankesit *** ** është i njëjti arsyetim për kallëzimet në mes të procesit të gjyimit kundër ekspertëve, sikurse te *** **. I qëndroj atij arsyetimi të qartë shterues për bindjet e mia dhe shtoj se mosfillimi im është lënë në fuqi nga Gjykata Tiranë, ...dhe çështja është gjykuar dhe trajtuar edhe në Prokurorinë Durrës e Gjykatën Durrës, me vendim të formës së prerë. Deri në këtë moment nuk ka asnjë vendim që cenon thëniet e mia për rastin, pra nuk ka cenim të besimit të publikut, pasi përcaktimet e mia bëjnë pjesë në një mesatare të pranueshme të mendimit juridik...”.

procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

22. Procedimi penal nr.*, të vitit 2015.** Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor, z. *** ***, ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit, me objekt “Shërbimet e printimit”, të shpallur nga OSSHEE sh.a., më datë ***.3.2015, me fond limit prej 42.124.000 lekë (pa TVSH). Autoriteti kontraktor ka shpallur fitues operatorin ekonomik “****-***” sh.p.k., i cili ka paraqitur 4 certifikata trajnimi për punonjësit e tij, të pretenduara se janë lëshuar nga prodhuesi i markës “RICOH”. Në kallëzimin e tij, të datës *.7.2015, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, i Kodit Penal, kallëzuesi *** **** parashtron se 4 certifikatat janë falsifikuar nga operatori ekonomik, me qëllim fitimin e procedurës së prokurimit, pasi ai i është drejtuar zyrtarisht shoqërisë “**** ***”, për verifikimin e 4 certifikatave dhe ka rezultuar se ato nuk ishin lëshuar nga prodhuesi, por ishin falsifikuar nga operatori ekonomik, me qëllim fitimin e procedurës së prokurimit.

22.1. Në datën *.9.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë i është drejtuar për ndihmë juridike, me anë të Ministrisë së Drejtësisë, autoriteteve holandeze për verifikimin e 4 certifikatave të trajnimit. Me shkresën nr.***/** prot., datë *.5.2016, Ministria e Drejtësisë i ka dërguar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë aktet e dërguara nga Ministria e Sigurisë dhe Drejtësisë e Mbretërisë së Holandës, bashkë me përkthimin përkatës. Me vendimin e datës *.5.2016, subjekti Gjergji Tako ka vendosur të pushojë procedimin penal nr. ***, të vitit 2015, me argumentin se nuk ka prova të mjaftueshme që përcaktojnë se fakti përbën veprë penale dhe se është paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dhe, meqenëse nuk ka ardhur përgjigjja nga autoritetet holandeze, ka vendosur pushimin e procedimit penal. Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me shkresën nr.*** prot., datë *.10.2016, bashkëlidhur së cilës gjendet informacioni i subjektit, ka kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme prishjen e vendimit të datës *.5.2016, për pushimin e procedimit penal si dhe rifillimin e hetimeve, për shkak të ardhjes së akteve nga autoritetet e huaja gjyqësore në ekzekutimin e letër-porosisë të dërguar. Me shkresën nr. *** prot., datë *.5.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, bazuar në kërkesën e subjektit për ndihmë juridike, i është drejtuar dhe një herë Ministrisë së Drejtësisë për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve holandeze.

22.2. Më pas rezulton se, me vendimin e datës *.6.2017, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal, pasi nuk ka prova të mjaftueshme që përcaktojnë se fakti përbën veprë penale. Në vendim arsyeton se është kërkuar ndihmë juridike nga autoriteteve gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë së Mbretërisë së Holandës, në datën *.4.2017, me shkresën nr. *** prot., nga autoritetet holandeze jemi në pritje të përgjigjes dhe, për këto arsye, në bazë të neneve 4, dhe 328/1/b, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur të pushojë procedimin penal nr. ***, të vitit 2015.

22.3. Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit kryesisht...”, ka konstatuar se: (i) vendimi i datës *.5.2016, për pushimin e procedimit penal është marrë pa administruar provat e nevojshme për të dalë në një konkluzion objektiv dhe ligjor; (ii) subjekti nuk ka administruar aktet e procedimit penal sipas parashikimeve të nenit 315 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) subjekti pa pasur shkaqe ligjore, ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të datës *.5.2016, për pushimin e procedimit penal pas afro 5 muajve nga ardhja e materialit të ekzekutimit të letër-porosisë nga Ministria e

Drejtësisë; (iv) kërkesa për ndihmë juridike, e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë **.5.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka sjellë si pasojë zvarritje të hetimeve; (v) Vendimi i datës **.6.2017, për pushimin e procedimit penal nr. ***/2015, është marrë pa administruar provat e nevojshme për të dalë në një konkluzion të drejtë ligjor, për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës.

22.4. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet¹⁵ në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin *“Rezultate të hetimit kryesisht...”*.

22.5. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

23. Procedimi penal nr. *, i vitit 2017.** Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, rezulton se shtetaset *** dhe *** dhe *** dhe ***, që dyshohen për kryerjen e veprës penale “Ekspertim i rremë”, janë caktuar si eksperte¹⁶ gjatë rigjyqimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të çështjes me të pandehurat *** dhe *** dhe *** dhe ***, akuzuar për veprën penale “Moskryerje e detyrës nga organet tatimore”. Pasi është njohur me aktin e ekspertimit, shtetasja *** dhe ***, në datën **.12.2013, ka paraqitur kallëzim penal ndaj ekspertëve *** dhe *** dhe ***, për kryerjen e veprës penale “Ekspertim i rremë”, i parashikuar nga neni 309, i Kodit Penal.

23.1. Në datën **.2.2007, ka depozituar kallëzim penal shtetasja *** (***), *** dhe ndaj punonjësve të Degës së Tatim-Taksave Tiranë, *** dhe *** e *** dhe ***, pasi administratorja e shoqërisë “***” sh.p.k. ka paraqitur 46 fatura tatimore shitje, për shitje të mallrave peshk edhe patate, drejt biznesit të vogël në Durrës, të *** dhe ***, ndërkohë që nuk është kryer një furnizim i tillë. Si pasojë, punonjësit e tatim-taksave i kanë marrë si të mirëqena këto fatura dhe e kanë ngarkuar kallëzuesen me detyrime tatimore në shumën 400.000 lekë, ndërkohë që duhet të verifikonin nëse këto fatura janë mbajtur sipas ligjit.

23.2. Komisioni, me aktin *“Rezultate të hetimit kryesisht...”*, ka konstatuar se: (i) vendimi i subjektit, i datës **.7.2017, për regjistrimin e procedimit penal nr. ***/2017, me arsyetimin se *“një procedim penal ndaj ekspertëve mund të niste vetëm në fund të shqyrtimit gjyqësor me një vendim të formës së prerë të çështjes”*, nuk është i mbështetur në nenin 309 të Kodit Penal; (ii) kërkesa e datës **.1.2018, për pushimin e çështjes penale nr. ***/2017, nuk mbështetet në nenin 309 të Kodit Penal; (iii) arsyetimi i subjektit në kërkesën e datës **.1.2018, për pushimin e çështjes penale nr. ***/2017, me argumentimin se: *“vendimi i Gjykatës së Lartë përkrah qëndrimin e ekspertëve”*, është i pavend (irrelevant); (iv) vendimi i datës **.11.2008, për pushimin e

¹⁵ Në pikën 24 të prapësimeve, parashtrime për 4.59, në dokumentin *“Përgjigje finale Vetting”*, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“...Gjetja e Komisionit se vendimi datë **.5.2016 është marrë pa u administruar prova të nevojshme për të dalë në një konkluzion objektiv dhe ligjor, është formalisht e drejtë, por praktikisht tejjet e gabuar. Është një praktikë shumëvjeçare, tashmë e konsoliduar që, me dërgimin e një letër-porositë jashtë shtetit, dosjet pezullohen ose pushohen, me qëllim të drejtpërdrejtë që të mos konsumohen afatet hetimore, si për personin, ashtu dhe veprën në tërësi... Nuk është e vërtetë që unë kam zvarritur pa arsye për 5 muaj prishjen e Vendimit të Pushimit, por kam gjykuar se prishja e Vendimit me debat gjyqësor do të ishte më cilësore se prishja e Vendimit brenda organit të Prokurorisë...Edhe për Vendimin e Pushimit të datës **.06.2017 vlen i njëjti arsyetim, që një dosje pushohet menjëherë pasi dërgohet një letër porosi për të mbyllur afatet e ligjshme efektive të hetimit pavarësisht, se kjo metodë nuk është metoda ideale për të mbyllur një procedim penal, por është e diktuar nga praktika shumëvjeçare...”*.

procedimit penal nr. ****, të vitit 2007, është marrë pa kryer veprimet e nevojshme hetimore për të vërtetuar faktin penal të pretenduar nga kallëzuesja, për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2015, i ka kaluar subjektit barrën e provës.

23.3. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet¹⁷, në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “Rezultate të hetimit kryesisht...”, duke e trajtuar si të tillë në vendimin e ndërmjetëm nr.9, datë 17.6.2022.

23.4. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se arsyetimi i subjektit në kërkesën e datës *.1.2018, për pushimin e çështjes penale nr. ***/2017, me arsyetimin se: “vendimi i Gjykatës së Lartë përkrah qëndrimin e ekspertëve”, nuk është i bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, duke treguar mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

24. Denoncim i shtetasit * ***, protokolluar në Komision me nr. *** prot. datë **.6.2021.** Ky shtetas ankohet¹⁸ se subjekti nuk ka kryer veprimet e domosdoshme hetimore për të verifikuar protokollin e lindjes natyrale, të ndjekur nga denoncuesi në cilësinë e mjekut obstetër-gjinekolog, si dhe ka devijuar akuzën në mënyrë të qëllimshme, duke shmangur nga ndjekja penale personin që ishte marrë me trajtimin e pacientes, nga momenti që kishte shfaqur shqetësime dhe deri sa humbi jetën.

24.1. Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ****, të vitit 2015¹⁹, kundër të pandehurit, *** ***, akuzuar për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit kryesisht ...”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) në vendimin për regjistrimin e emrit të personit nën hetim, aktin e njoftimit të akuzës të pandehurit dhe në kërkesën për gjykim të datës *.11.2015, nuk ka arsyetuar lidhur me shkakun determinant të ardhjes së pasojës fatale për jetën të shtetasës *** ***, (ii) në aktin e njoftimit të akuzës së të pandehurit *** *** dhe në kërkesën për gjykim të datës *.11.2015, nuk ka arsyetuar lidhur me qëndrimin e kundërt me konkluzionet e akt-ekspertimit mjeko-ligjor; (iii) në kërkesën për gjykim të datës ***.11.2015, nuk ka arsyetuar se cilat janë veprimet apo mosveprimet e të pandehurit që nuk përputhen me protokollet mjekësore. Për faktet e konstatuara, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

¹⁷ Në pikën 23 të prapësimeve, parashtrime për 4.78, në dokumentin përgjigje finale Vetting, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “...Hetimi shprehet se në vendimin për regjistrim të procedimit penal nr. ***/2017, është e gabuar shprehja nga ana ime se: ‘Një procedim penal ndaj ekspertëve mund të nisë vetëm pas mbarimit të shqyrtimit gjyqësor me vendim të formës së prerë’. Me duhet të them se unë i qëndroj mendimit tim që pretendimet për veprimtarinë e një eksperti nga njëra palë apo nga të gjitha palët i merr në shqyrtim fillimisht Gjykata që i ka thirrur ata si ekspert. Që eksperti të ketë konsumuar nenin 309 të K. Penal, ai nga ana subjektive duhet ta ketë bërë me dashje apo për përfitime monetare dhe nga ana objektive të ketë realizuar një ekspertim objektivisht të gabuar... Nëse ana subjektive është ekskluzivitet i një procesi penal për t’u provuar ana objektive, pra nëse ekspertimi është objektivisht i gabuar, vlerësohet nga Gjykata që e ka thirrur ekspertin për ekspertim. Nëse kjo Gjykatë, pasi dëgjon pretendimet e palëve, në këtë rast të *** *** dhe të Prokurorisë nga njëra anë dhe të të pandehurve nga ana tjetër, vendos se ekspertimi e bind dhe është i drejtë, atëherë ekspertimi nuk është i gabuar objektivisht, e për rrjedhojë, nuk mund të regjistrohet procedim penal, pasi mungon njëri element i figurës së veprës penale, ana objektive... Në lidhje me mungesën e arsyetimit të kërkesës datës *.1.2018, për pushimin e çështjes penale ***/2017 dhe fakti që nuk kam kryer të gjitha veprimet hetimore... shpjegoj se, përderisa Gjykata e Apelit ka dhënë një vendim të formës së prerë për pushimin e çështjes, nuk mund të thuhet se nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore...”.

¹⁸ Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit Vendimin e Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë nr. ***, datë *.7.2017, me të cilën është shpallur i pafajshëm. Referuar shkresës së Gjykatës së Apelit Tiranë, me nr. ***/** prot., datë *.2.2022, çështja është regjistruar dhe pret të gjykohej pranë kësaj gjykate.

¹⁹ Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me shkresën nr. ***/** prot., datë *.2.2022.

24.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet²⁰, në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

24.3. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit, kritere të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

25. *Denoncim online i shtetasit* *** **²¹. Ky shtetas akuzon subjektin për fshehje të provave, si dhe në mënyrë të qëllimshme ka dërguar për gjykim shtetasen *** ** (ish-bashkëshorten e tij), vetëm me akuzën e pengimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës dhe nuk ka hetuar për rrëmbimin dhe kalimin jashtë territorit të djalit të tij, si dhe faktin kush e ka pajisur me dokumente të falsifikuara.

25.1. Në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. *, të vitit 2018**, kundër së pandehurës *** ** (***), akuzuar për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, Komisioni, në aktin “*Rezultatet e hetimit kryesisht...*”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar veprimet hetimore për verifikimin e aktit me të cilin ka kaluar në kufi i mituri *** **, fakt për të cilin, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

25.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet²² në prapësimet e datës 21.4.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

25.3. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

26. Kallëzim penal me nr. *, datë **.1.2014.** Nga shqyrtimi i vendimit datë **.3.2014, për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë **.1.2014, ndaj shtetasit *** **, akuzuar për veprën penale “Ndërtim pa leje”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, rezulton se sipas procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, në banesën e shtetasit *** ** është konstatuar 1 kolonë e ndërtuar dhe e betonuar, dhe mbi banesë janë konstatuar disa hekura në formë kolone dhe armaturë dërrase, gati për t’u betonuar. Gjithashtu, në procesverbalin e datës **.3.2014, pasqyrohet se shtetasi *** **, lidhur me pyetjen e Oficerit të Policisë Gjyqësore, nëse ka kërkuar leje për ndërtimin, është përgjigjur se nuk ka bërë kërkesë zyrtare, pasi sipas tij lejet e ndërtimit në Tiranë ishin bllokuar. Në vendimin datë **.3.2014, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsytimin se “...kjo çështje nuk është vepër

²⁰ Në pikën 22 të prapësimeve, dokumenti “*përgjigje finale Vetting*”, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se në fjalinë e fundit të arsytimit si në kërkesën për gjykim, si në aktin e akuzës, si dhe në regjistrimin e emrit të personit nën hetim, konkretisht shprehem: “... fillesa e pasojës është moshënimi në kartelë i metodologjisë së përdorur për lindjen nga mjeku *** **, duke mos i pajisur me dyshimin rreth dëmtimit të shprekës mjekët e tjerë në vijim... Pikërisht këtu gjendet edhe shkelja protokollare që ka bërë mjeku *** **, që është mosplotësimi i kartelës në mënyrën e duhur”.

²¹ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **.6.2021.

²² Në pikën 21 të prapësimeve, dokumenti *Përgjigje finale Vetting*, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... është shumë e lehtë për persona të pajisur ligjërisht me sistemin TIMS për të vërejtur se shtetasit *** **, *** ** etj., janë rregullisht të regjistruar në momentin e kalimit të kufirit, e kanë kaluar kufirin në një pikë zyrtare dhe nuk kanë paraqitur deklarate noteriale, pasi rubrika ‘shënime të tjera është bosh’...”

penale, pasi nuk kemi krijimin e një sipërfaqe të re ndërtimore, sepse fillesa e ndërtimit pa leje është mbi katin e parë të një banese ekzistuese”.

26.1. Komisioni, në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka kryer hetimet e nevojshme për të verifikuar faktin nëse i dyshuari ka ndërtuar në pronë publike; (ii) në vendimin për mosfillimin e procedimit penal nuk ka analizuar ligjin për planifikimin e territorit, si dhe nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal²³, fakte për të cilat i ka kërkuar subjektit shpjegime.

26.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet²⁴ në prapësimet shtesë të datës *.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

26.3. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e aftësisë për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin²⁵, nr.10119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit” (i ndryshuar), që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së ndërtimit. Gjithashtu ka shfaqur mangësi edhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

27. Procedimi penal me nr. *, viti 2015**

27.1. Nga shqyrtimi i akteve në fashikullin penal të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit *** ***, rezulton se Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) ka shfaqur mangësi në aspektin e arsytimit ligjor të kërkesës për dërgimin për gjykim të çështjes, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës; (ii) nga shqyrtimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal lidhur kallëzimin penal nr.***, datë *.1.2014 dhe i kërkesës për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, datë *.8.2015, duket se subjekti ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me anën objektive të kryerjes së veprës penale “Ndërtim i paligjshëm”, i parashikuar nga neni 199/a, i Kodit Penal, në rastet kur shtetasit janë konstatuar se po kryenin ndërtim të paligjshëm mbi banesën e tyre ekzistuese, fakte për të cilat, në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës.

27.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”.

²³Kodi Penal, neni 199/a: *Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.*

Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

²⁴ Në parashtrimet për raportin shtesë, datë 3.6.2022, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... Në juridiksionin penal parimi themelor është se interpretimi juridik duhet të jetë ngushtues, ...pasi dyshimet duhet të arsyetohen në favor të të pandehurit. Pikërisht mbi këtë parim mbajta qëndrim që ndërtimet që krijojnë sipërfaqe dhe volum shtesë, jo të lidhura drejtpërdrejt me tokën, të trajtoheshin si kundërvajtje administrative, ndërsa ato të lidhura drejtpërdrejt me tokën që krijojnë sipërfaqe dhe volum shtesë, të trajtoheshin si vepra penale...”. Lidhur me moskryerjen e hetimeve për të verifikuar faktin nëse i dyshuari ka ndërtuar në pronë publike, subjekti, në të njëjtat parashtrime, ka prapësuar se: “...Ky përfundim i hetimit nuk qëndron. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet OPGJ-së, ka kryer të plota veprimet hetimore për të përcaktuar statusin e kolonës për të cilën referon kallëzuesja në deklarinimin e saj...”.

²⁵ Nuk ka arsytuar në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 191 të Kodit të Procedurës Penale: “Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsytuar për mosfillimin e procedimit...”.

27.3. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në indikatorin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, në kuptim të pikës 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

28. Për mosfillim të procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. *, viti 2014**

Nga shqyrtimi i akteve në fashikullin penal të kallëzimit penal nr. ***, të vitit 2014, për kryerjen së veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, ankues shtetasi *** ***, rezulton se Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit kryesisht shtesë”, ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal; (ii) ka shfaqur mangësi në aspektin ligjor të marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal, pasi në kushtet kur në rastin konkret jemi përpara një kallëzimi penal të shtetasve të dëmtuar (neni 90 i Kodit Penal), arsytimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal është mjaft i rëndësishëm, pasi në bazë të nenit 291, i Kodit të Procedurës Penale, kallëzuesit kanë të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit.

28.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në rapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “Rezultate të hetimit kryesisht shtesë”.

28.2. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në indikatorin e arsytimit ligjor në kuptim të pikës 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

29. Për mosfillim të procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. *, viti 2015**

29.1. Për vendimin për mosfillimin e procedimit penal, lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit *** ***, për kryerjen e veprës penale “Mosbindje ndaj punonjësit që ruan rendin publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, rezulton se Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit kryesisht shtesë”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka pasqyruar në arsytimin e vendimit se cilat janë nenet e Kodit Penal që mbrojnë veprimtarinë e rregullt të organeve të policisë së rendit publik, cilat janë veprimet ose mosveprimet që parashikon secila dispozitë për t’u konsideruar e konsumuar nga ana objektive vepra penale përkatëse dhe pse në rastin konkret nuk vërtetohet shkelja e këtyre dispozitave; (ii) vetëm nëpërmjet një analize të tillë, vendimi i subjektit do të përmbushte kriterin e një vendimi të arsytuar, i cili lidhet dhe me të drejtën e ankimit të kallëzuesve, për të cilat i ka kërkuar sqarime.

29.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në rapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “Rezultate të hetimit kryesisht shtesë”, duke e trajtuar si të tillë në *vendimin e ndërmjetëm nr.9, datë 17.6.2022*.

29.3. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në indikatorët e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor në kuptim të pikave 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

30. Për mosfillim të disa procedimeve penale lidhur me veprën penale “mbajtje lëndë narkotike”

30.1. Nga shqyrtimi i akteve të procedimeve penale: nr. ****²⁶, të vitit 2013; nr. ****²⁷, të vitit 2015; nr. ****²⁸, të vitit 2014; nr. ****²⁹, të vitit 2016 dhe nr. ****³⁰, të vitit 2016, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “mbajtje lëndë narkotike”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit kryesisht shtesë”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të përcaktimit të nocionit ligjor-penal “dozë e vogël”, për efekt të zbatimit të nenit 283, të Kodit Penal dhe si pasojë konkluzioni se në rastin konkret janë konstatuar kushtet e mbajtjes së lëndës narkotike në sasi mjaft të vogla nuk është i mbështetur në përcaktimin e ekspertit toksikolog; (ii) ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, për të analizuar jurisprudencën, si dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë, si cilësia e analizës; (iii) vendimi “për pushimin e procedimit penal” është marrë si pasojë e mosanalizimit të elementeve të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 283, i Kodit Penal, i jurisprudencës dhe moskryerja e veprimeve të nevojshme hetimore në drejtim të përcaktimit të nocionit juridik penal “dozë e vogël”. Për sa konstatuar, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

30.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “Rezultate të hetimit kryesisht shtesë”.

30.3. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në vendimmarrjet përkatëse për pushimin e procedimeve penale, nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit/dyshuarit, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën (*vendim penal nr.1, datë 27.3.2008, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*), si dhe në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës, kritere të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar). Përveç këtyre konstatimeve, subjekti i rivlerësimit në tri³¹ raste nuk ka kërkuar kryerjen e akt-ekspertimit klinik të lëndës së sekuestruar dhe në një rast³² nuk ka administruar akt-ekspertimin toksikologjik, elemente thelbësore qoftë në identifikimin e veprës penale, sikundër individualizimin e përgjegjësisë së subjektit në kryerjen e saj.

31. Procedimi penal nr. *, viti 2014**

31.1. Për vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “Ndotja e ajrit”, në ngarkim të shtetasit *** ***, të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit kryesisht shtesë”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka analizuar legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit lidhur me nivelin e parametrave të shkarkimit në ajër të elementeve kimike të pasqyruara në

²⁶ Në ngarkim të shtetasit *** ***.

²⁷ Në ngarkim të shtetasit *** ***.

²⁸ Në ngarkim të shtetasit *** ***.

²⁹ Në ngarkim të shtetasit *** ***.

³⁰ Në ngarkim të shtetasit *** ***.

³¹ Procedimet penale me nr. ***/2015, nr. ***/2014 dhe nr. ***/2016.

³² Procedimi penal me nr. ***/2016.

informacionin e AKM-së, që përbën kundërvajtje administrative, në kundërshtim me nenin 201, të Kodit Penal; (ii) arsyetimi në vendimin për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se “në kushtet kur nuk është përdorur si lëndë djegëse goma dhe plastika, nuk kemi të bëjmë me ndotje mjedisi në parametra penale”, është i pavend (irrelevant); (iii) vendimi për “pushimin e procedimit penal” është marrë si pasojë e mosanalizimit të legjislacionit mjedisor lidhur me nivelet e lejuara dhe ato që përbëjnë kundërvajtje administrative të elementeve të shkarkimit në ajër të pasqyruara në informacionin e AKM-së dhe për shkak të interpretimit ndryshe i fakteve të konstatuara gjatë hetimit. Për sa konstatuar, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

31.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”.

31.3. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në indikatorët e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, në kuptim të pikave 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

32. Procedimi penal me nr. *, viti 2016**

32.1. Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, në ngarkim të shtetasit *** ***, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për sqarimin e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 290, i Kodit Penal, “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, pasi në aktin e ekspertimit auto-teknik vërehen këto mangësi: (a) nuk është sqaruar sinjalistika vertikale dhe horizontale e segmentit rrugor në të cilin ka ndodhur aksidenti dhe nëse është respektuar nga drejtuesi i mjetit; (b) nuk është sqaruar shpejtësia e lejuar për automjetet në segmentin rrugor ku ka ndodhur aksidenti; (c) akti i ekspertimit është i paplotë lidhur me përcaktimin e shpejtësisë së aksidentit, pasi eksperti shprehet se automjeti ka ndalur menjëherë në vend dhe nuk janë konstatuar gjurmë frenimi, por nuk ka shpjeguar se sa është kufiri maksimal i shpejtësisë së automjetit në lëvizje kur ai ndalon menjëherë dhe nuk shkakton gjurmë frenimi; (ii) subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore me qëllim përcaktimin e anës subjektive të kryerjes së veprës penale të dyshuar, pasi nuk ka kërkuar nga eksperti auto-teknik të përcaktojë nëse aksidenti mund të shmangej nga drejtuesi i automjetit, nëse lëvizja e automjetit do të ishte brenda shpejtësisë së lejuar në atë segment rrugor. Për sa konstatuar, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

32.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”.

31.3. Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në indikatorin e njohurive ligjore në kuptim të pikës 2, të nenit 73, dhe indikatorin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, në kuptim të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

33. Procedimi penal me nr. *, viti 2013**

33.1. Për kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje”, në ngarkim të shtetasit *** ***,

të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, ka konstatuar në mënyrë të përmbledhur, se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 130/a, i Kodit Penal, si dhe nuk ka arsyetuar se pse në rastin konkret nga ana e të pandehurit janë konsumuar njëkohësisht të gjithë elementet e kësaj figure të veprës penale, në mënyrë që i akuzuari të ushtrojë të drejtën e tij, për të realizuar një mbrojtje efektive, për të cilat i ka kërkuar subjektit shpjegime.

33.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”.

33.3. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në indikatorin e arsytimit ligjor, në kuptim të pikës 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (i ndryshuar).

34. Procedimi penal me nr. *, viti 2015**

34.1. Për kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “Mashttrim”, në ngarkim të shtetasit *** ***, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, konstaton se subjekti i rivlerësimit: (i) në kërkesën për gjykimin e çështjes në gjykatë nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga nenet 143, 298, të Kodit Penal, si dhe nuk ka arsyetuar se pse në rastin konkret nga ana e të pandehurit janë konsumuar njëkohësisht të gjitha elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 143 dhe nuk janë konsumuar elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 298. Në vendim, subjekti ka pasqyruar faktet e konstatuara gjatë hetimit dhe ka bërë vetëm interpretimin logjik të tyre. (ii) Mungesa e arsytimit në kërkesën për gjykim të prokurorit cenon të drejtën e individit për t’u vënë në dijeni për shkakun e akuzës kundër tij, për të realizuar një mbrojtje efektive, për të cilat i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime.

34.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”.

34.3. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (të ndryshuar).

35. Procedimi penal me nr. *, viti 2015**

35.1. Në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “Fshehje të ardhurash”, në ngarkim të shtetasit *** ***, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, konstaton se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka bërë analizën e elementeve të veprës penale “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180, i Kodit Penal, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë lidhur me cilësimin juridik të veprës penale; (ii) Kërkesa “Për dërgimin e çështjes penale për gjykim” ka ardhur si pasojë e mosanalizimit të elementeve të figurës së veprës penale “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180, i Kodit Penal, të anës objektive të saj dhe në përcaktimin se cilët janë subjektet e kësaj vepre penale. Për faktet e konstatuara, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

35.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht...*”.

35.3. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizën e elementeve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, parashikuar në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (të ndryshuar).

36. Procedimi penal me nr. *, viti 2016**

Për vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, në ngarkim të shtetasve *** ***, etj., të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, Komisioni, me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, konstaton se subjekti i rivlerësimit: (i) në vendimin “për pushimin e procedimit penal”, nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal, “Ushtrimi i ndikimit ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”; (ii) duke marrë në konsideratë jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendim unifikues nr. 2, datë 20.6.2013, Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë), është konkluduar se vendimi i pushimit të çështjes nga ana e prokurorit, para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2017, është një vendim *quasi* gjyqësor, që ka të bëjë me dhënien e drejtësisë, vlerëson se arsytimi i vendimit “Për pushimin e procedimit penal”, është mjaft i rëndësishëm. Për sa ka konstatuar, Komisioni, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

36.1. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”.

36.2. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në indikatorin e njohurive ligjore dha atë të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (të ndryshuar).

37. Për procedimin penal me nr. *, viti 2016**

37.1. Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “Shkelje e barazisë në tendera”, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, Komisionin me aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”, konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit, në vendimin për “pushimin e procedimit penal”, nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 258, i Kodit Penal, “Shkelje e barazisë në tendera”; (ii) duke marrë në konsideratë jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendim unifikues nr. 2, datë 20.6.2013, Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë) është konkluduar se vendimi i pushimit të çështjes nga ana e prokurorit, para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2017, është një vendim *quasi* gjyqësor, që ka të bëjë me dhënien e drejtësisë, vlerëson se arsytimi i vendimit “Për pushimin e procedimit penal”, është mjaft i rëndësishëm. Për sa konstatuar, Komisioni, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

37.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet në prapësimet shtesë të datës 13.6.2022, të cilat nuk kanë qenë bindëse dhe, përfundimisht, Komisioni i ka qëndruar gjetjeve të pasqyruara në aktin “*Rezultate të hetimit kryesisht shtesë*”.

37.3. Komisioneri Publik, për sa më lart, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në indikatorin e njohurive ligjore dhe atë të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 (të ndryshuar).

38. Komisioni, pasi i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për sa ka konstatuar, ka administruar prapësimet e subjektit të rivlerësimit, në përfundim, ka marrë vendimin e ndërmjetëm nr. 9, nr. 464 akti, datë 17.6.2022, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] *trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mangësi në drejtim të njohurive ligjore bazuar në aftësinë për të hetuar, duke mos ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave të ligjore, duke mos mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe duke mos interpretuar ligjin; (2) ka mangësi në drejtim të arsytimit ligjor bazuar në mosqartësimin dhe moskuptueshmërinë e akteve të Prokurorisë, dhe mosanalizimin dhe arsytimin logjik të prokurorit, sipas parashikimeve në pikës 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar... Subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, të thellohej në arsytimin e vendimeve, të pasqyronte analizën e elementeve të figurës së veprës penale, të vepronte në përputhje me jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe të analizonte legjislacionin përkatës në rastet kur dispozita e Kodit Penal ishte blankete (e bardhë). Për këto arsye dhe për sa janë analizuar më sipër, sipas përcaktimeve të nenit 44, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konsiderohet “Me mangësi”, të cilat mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda 1 viti [...].*

39. Komisioni, për sa më sipër, në vendimin e ndërmjetëm nr. 9, nr. 464 akti, datë 17.6.2022, me anë të së cilit ka vendosur pezullimin me afat 1-vjeçar nga detyra të subjektit dhe detyrimin e ndjekjes së programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *subjekti ka shfaqur në mënyrë të përsëritur mangësi në ndjekjen logjike të hetimit sipas kërkesave ligjore në arsytimin e vendimeve, në analizën e elementeve të figurës së veprës penale, në analizimin e jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe në analizimin e legjislacionit përkatës në rastet kur dispozita e Kodit Penal ishte blankete (e bardhë), vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e plotësimit të këtyre mangësive nëpërmjet një programi trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës [...].*

40. Ndërsa, në vendimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: [...] *Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. **, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit... dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë [...].*

41. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve: **(i)** referuar kompetencës kushtetuese që e detyron prokurorin të luajë një rol themelor dhe të mbart përgjegjësi të rëndësishme në administrimin e drejtësisë

në emër të shoqërisë dhe interesit publik; **(ii)** duke vlerësuar se veprimet dhe mosveprimet e magjistratit/prokuror në kuadër të ndjekjes penale kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe/ose cenimin e interesit të individëve dhe të Shtetit; **(iii)** duke mbajtur në konsideratë se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë është pazgjidhshmërisht i lidhur me transparencën, efektivitetin, profesionalizmin dhe integritetin e treguar nga magjistratët në ushtrimin e detyrës së tyre, çmon se, gjatë kontrollit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ai ka dështuar të ketë nivelin minimal kualifikues.

42. Komisioneri Publik, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017³³, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe çmon se në kontrollin e aftësisë profesionale, subjekti i rivlerësimit nuk e ka kaluar nivelin kualifikues për konfirmimin e tij në detyrë dhe se subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur në kushtet që mangësitë e evidentuara nuk mund të plotësohen, as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, siç ka vendosur me vendim të ndërmjetëm Komisioni.

43. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, sikundër u parashtrua më lart në këtë ankim, Komisioneri Publik vjen në përfundimin se veprimtaria profesionale e subjektit të rivlerësimit, e materializuar në veprimet dhe mosveprimet e tij vijuese në shkelje të detyrimeve ligjore, është e shoqëruar dhe vjen si pasojë e njohurive, aftësive, gjykimeve dhe qëndrime të tilla që përfaqësojnë haptazi një model të vepruari aq të dobët, sa kurrsesi nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe se mangësitë e thella e të rëndësishme të verifikuara nuk mund të korrigjoheshin përmes programit njëvjeçar të edukimit, e për pasojë, duhet të zbatohet prezumimi në favor i masës disiplinore të shkarkimit, sipas nenit E, pika 4 e aneksit të Kushtetutës.

44. Subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe, për pasojë, duhet të konsiderohet si i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e prokurorit, sipas parashikimit të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Për shkak të këtij përfundimi, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë në një nga rastet e parashikuara për shkarkimin nga detyra.

III.B Gjetje të tjera

45. Komisioneri Publik vëren se, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, dalin çështje të evidentuara në kontrollin e kriterit të pasurisë, si në vijim:

46. Pasuria e luajtshme, automjet i markës “Mercedes -Benz”, me targë të huaj **.--*** dhe në vijim me targë ** *** ****

46.1. Në D-Vetting, subjekti deklaroi automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë ** *** **, blerë në vitin 2005, me burim krijimi huan e marrë nga shtetasja ***. ***, vlera 5.100 euro. Pjesa takuese 100%.

³³ Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, në paragrafin 54 të tij, ndër të tjera, citohet se në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë se: [...] Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)[...].

46.2. DV-2005 (data e dorëzimit **.3.2006), subjekti i rivlerësimit deklaroi blerjen e automjetit tip “*M-B Klas C*”, për çmimin 5.000 euro, me pjesë takuese 100%.

46.3. Në dosjen e Komisionit, në lidhje me këtë pasuri, janë administruar, ndër të tjera: (1) kontratë shitje e datës **.3.2005, me palë shitëse **. (**.), me palë blerëse subjekti, z. Tako, me objekt shitje automjeti *Mercedes-Benz*, me shasi nr.***, për çmimin 5.100 euro. (2) shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor³⁴ (në vijim referohet si DPSHTRR), bashkëlidhur së cilës gjenden: (i) dokumenti i lëshuar nga komandanti i V.K.K. “Tre urat”, që vërteton se automjeti ka hyrë në këtë pikë kalimi kufitar në datën **.8.2006; (ii) deklarata doganore e vitit 2006, ku pasqyrohet se shtetasit Gjergji Tako e *** ** kanë shlyer detyrimin doganor në shumën 186.528 lekë; (iii) vërtetim zhdoganimi datë 17.8.2006; (iv) leja e qarkullimit, lëshuar në datën **.11.2006. (3) shkresë e DPPSH-së,³⁵ që informon se nga verifikimi në sistemin TIMS rezultoi se për automjetin tip “*Mercedes-Benz*”, me targë **-* ***, ka një regjistrim në territorin shqiptar, në datën **.12.2004.

46.4. Komisioni, me aktin “*Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht*”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera, në lidhje me konstatimin se: [...] *Veprimet e subjektit për përdorimin e automjetit me targë ** ***, për periudhën **.3.2005 – **.11.2006, pa leje qarkullimi dhe pa e regjistruar në degën përkatëse të DPSHTRR-së, si dhe me paraqitjen e një dokumenti të ndryshëm nga ai që administron DPPSH-ja lidhur me datën e hyrjes në territorin shqiptar të këtij automjeti, nuk është në përputhje me etikën e një magjistrati jashtë ushtrimit të funksionit të tij [...].*

46.5. Në përgjigje të rezultateve të hetimit³⁶, subjekti, ndër të tjera, ka pretenduar se mjeti nuk ka dalë në përdorim në rrugët publike, pasi ka qëndruar në oborrin e banesës së shtetasit ***. ***, për 2-3 muaj. Gjithashtu ka pretenduar se ndaj shoqërisë dhe shtetit nuk ka shkaktuar asnjë dëm pasuror, pasi automjeti nuk është përfshirë në asnjë aksident për periudhën kur ishte i pazhdoganuar (***.3.2005 – ***.8.2006) dhe ndaj tij nuk ka ngritur asnjë person padi civile për dëmshpërblim për periudhën ***.1.2004 – ***.1.2011.

46.6. Komisioni, lidhur me sa më sipër, ka arritur në përfundimin se: [...] *me shlyerjen e detyrimeve doganore dhe regjistrimin e automjetit pranë DPSHTRR-së, pavarësisht se me vonesë, subjekti i rivlerësimit ka treguar se nuk ka pasur si qëllim shmangien nga zbatimi i Kodit Rrugor dhe legjislacionit doganor. Si pasojë, Komisioni, duke marrë në konsideratë parimin e proporcionalitetit, vlerëson se parregullsia e konstatuar në zbatimin e Kodit Rrugor dhe legjislacionit doganor nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si shkak i vetëm që prodhon situatën e cenimit të besimit të publikut ... regjistrimi me vonesë i automjetit me targë ** ***, pranë DPSHTRR-së do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurisë³⁷ [...].*

46.7. Komisioneri Publik vëren se: (i) Komisioni ka konstatuar drejt lidhur me mospërmbushjen e detyrimeve ligjore nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket shlyerjes së detyrimeve doganore; (ii) subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 93 të ligjit

³⁴ Shkresa me nr. ***/** prot., datë **.11.2021.

³⁵ Shkresë nr. ***/** prot., datë **.12.2021.

³⁶ Email, datë **.4.2022.

³⁷ Referohuni pikës 4.19 dhe 4.20 të vendimit të Komisionit.

nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, duke mosregjistruar pronësinë e mjetit dhe duke mos kryer targimin e tij.

47. Pasuria e luajtshme, autoveturë e markës “Volkswagen MH2 Golf”, me numër shasie ***

47.1. Në D-Vetting, subjekti deklaron blerjen e automjetit në vitin 2005, për çmimin 90.000 lekë, me pjesë takuese 100%, me burim krijimi të ardhura vjetore të familjes dhe mbyllja e depozitës bankare në *** Bank. Në vijim, subjekti deklaron se *automjeti ka kaluar në pronësi të shtetit për shkak të pamundësisë së shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, viti 2010.*

47.2. DV-2005 (data e dorëzimit **.3.2006), subjekti i rivlerësimit deklaron blerjen e automjetit tip “WW GOLF 2”, për çmimin 90.000 lekë, me pjesë takuese 100%.

47.3. Në dosjen e Komisionit, në lidhje me këtë pasuri, ndër të tjera, është administruar Kontratë shitje e datës **.12.2005, me palë shitëse z. ***, ***,³⁸ dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit. Objekt i kontratës është shitja e automjetit tip “Volkswagen”, me nr. shasie ***, për çmimin 90.000 lekë. Në kontratë përcaktohet në mënyrë të veçantë që blerësi të bëjë zhdoganimin dhe regjistrimin e mjetit. Në dokumentacionin e administruar nga noteri ***, ***,³⁹ rezulton se bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet dokumenti “Vërtetim hyrje”, i datës *.9.2005, i doganës, në emër të shtetasit ***, ***, ku pasqyrohet se automjeti me targë *** është i destinuar për qëndrim të përkohshëm.

47.4. Në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shprehet se: [...] *Automjeti i markës Volkswagen Golf 2 nuk është regjistruar pranë autoriteteve për pamundësi financiare. Ky automjet është bllokuar nga Policia në datën **.10.2010 [...].*

47.5. Komisioni, me aktin “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: [...] *Veprimet e subjektit për përdorimin e automjetit me targë ***, pa leje qarkullimi, pa e regjistruar në degën përkatëse të DPSHTRR-së, si dhe pa paguar detyrimet doganore, nuk janë në përputhje me etikën e një magjistrati jashtë ushtrimit të funksionit të tij [...].*

47.6. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁴⁰, subjekti, ndër të tjera, përgjigjet se automjeti ka qëndruar poshtë banesës së shtetasit *** *** dhe se nuk ka qenë përdorues efektiv i vërtetë i këtij mjeti.

47.7. Komisioni, lidhur me sa më sipër, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit ka provuar se, pavarësisht se i kishte kaluar pronësia me kontratën nr. ***/***, datë **.12.2005, nuk ishte përdorues i automjetit tip “Volkswagen Golf 2”, por shtetasi ***, ***, dhe ishte ky i fundit që ka përdorur një automjet pa u pajisur me leje qarkullimi dhe pa shlyer detyrimet doganore ... subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për regjistrimin pranë DPSHTRR-së të ndryshimit të pronësisë së automjetit tip “Volkswagen Golf,” mangësi e cila do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurisë⁴¹[...].*

³⁸ Përfaqësuar me prokurë të posaçme nga znj. ***, ***.

³⁹ Shkresë e datës **.2.2022.

⁴⁰ Email, datë **.4.2022.

⁴¹ Referohuni pikës 5.12 dhe 5.13 të vendimit të Komisionit.

47.8. Komisioneri Publik, lidhur me sa më sipër, vëren se edhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit rezulton se ka patur në pronësi për rreth 5 vite këtë automjet pa leje qarkullimi, pa e regjistruar në DPSHTRR, si dhe pa paguar detyrimet doganore. Duket se kjo qasje, në respektimin e detyrimeve ligjore, ka përfaqësuar një mënyrë sjelljeje të përsëritur nga ana e subjektit të rivlerësimit.

48. Pasuria e luajtshme, automjetet i markës “Mercedes-Benz”, me targë origjine ** * **.**

48.1. Në D-Vetting, subjekti deklaron blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë origjine ** *** **, me burim krijimi të ardhurat e bashkëshortes, blerë sipas veprimit juridik të datës **.10.2016. Automjeti është plotësisht jashtë funksionit dhe përdorimit. Vlera 135.000 lekë, pjesë takuese 100%,

48.2. Në dosjen e Komisionit, në lidhje me këtë pasuri, ndër të tjera, janë administruar: (i) kontratë shitje e datës **.10.2008, me palë shitëse ***.***., me palë blerëse shtetasin ***.***., me objekt shitje automjeti Mercedes-Benz, me nr. shasie ***, për çmimin 5.500 euro; (ii) prokurë e posaçme e datës **.10.2012, me nr.*** rep., dhe nr. *** kol., ku shtetasi ***.***., në cilësinë e pronarit të automjetit autorizon subjektin e rivlerësimit, z. Tako, të përdorë mjetin në fjalë për nevoja pune dhe familjare brenda dhe jashtë Shqipërisë, të paraqitet para çdo organi administrativ shtetëror për të bërë zhdoganimin e mjetit, të bëjë tjetërsimin (shitjen ose dhurimin) e këtij mjeti vetes apo personave të tretë, të bëjë nxjerrjen jashtë qarkullimit sipas çmimit që do të gjykojë të arsyeshëm; (iii) shkresa e thjeshtë e datës **.10.2016 e nënshkruar nga shtetasi ***.***., në cilësinë e shitësit dhe subjekti i rivlerësimit, z. Tako, në cilësinë e blerësit, ku palët bien dakord për shitjen e automjetit me targa të origjinës ** *** ** kundrejt çmimit 135.000 lekë; (iv) shkresa e DPSHTRR-së⁴², ku thuhet se mjeti me targë ** *** **, nuk figuron i regjistruar⁴³.

48.3. Komisioni, me aktin “Relacion i rezultateve të hetimit kryesisht”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimet se: [...] (i) subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në përdorim, pasi nga hetimi rezulton se subjekti e ka poseduar me të drejta të plota sikur të ishte pronar këtë automjet që nga viti 2012; (ii) referuar konstatimit në pikën më lart, duket se vetë veprimet e subjektit për përdorimin e këtij automjeti për një periudhë afërsisht 4-vjeçare, pa leje qarkullimi, pa e regjistruar në degën përkatëse të DPSHTRR-së, si dhe pa paguar detyrimet doganore, nuk janë në përputhje me etikën e një magjistrati jashtë ushtrimit të funksionit të tij [...].

48.4. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁴⁴, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale të datës **.4.2022, të shtetasit ***.***., i cili deklaron se automjetin në fjalë e ka blerë për nevoja personale dhe nuk ka arritur ta zhdoganojë, për shkak se disa ditë pas blerjes pësoi defekt të rëndë dhe nuk mund të lëvizte dot. Gjithashtu, ky shtetas deklaron se tagrat e dhëna prej tij në prokurën e datës **.10.2012, me përfitues subjektin, z. Tako, nuk u realizuan,

⁴² Referohuni shkresës me nr.***/** prot., datë **.10.2021.

⁴³ Referuar akteve në dosje për këtë mjet, subjekti ka depozituar dhe një akt shitje me nr. serial ***, datë **.5.2018, në vlerën 50.000 lekë.

⁴⁴ Email, datë **.4.2022.

përveç dy-tre rasteve kur automjeti ka lëvizur për efekt testimi për rregullim defekti, i cili nuk u rregullua dhe gjendja mbeti njësoj deri në shitjen përfundimtare për pjesë këmbimi.

48.5. Komisioni, lidhur me sa më sipër, ka arritur në përfundimin se: [...] *krijon bindjen se automjeti tip "Mercedes Benz," me targë ** *** **, për periudhën nga viti 2012, deri në lidhjen e aktmarrëveshjes (për shitblerje automjeti), të datës **.10.2016, nuk ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe se ka provuar që ky automjet ka qenë jashtë funksionit⁴⁵[...].*

48.6. Komisioneri Publik çmon se përfundimi i arritur nga Komisioni lidhur me këtë automjet, nuk është i bazuar në një vlerësim të drejtë të rrethanave të përdorimit të këtij mjete, pasi prokura e posaçme e datës **.10.2012 nuk rezulton të jetë revokuar deri në datën **.10.2016, kur është përpiluar shkresa e thjeshtë për shitje mjete, duke prezumuar kështu përdorimin e tij nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e shtetasit ***.***., në deklaratën e datës **.4.2022, se disa ditë pas blerjes automjeti pësoi defekt të rëndë dhe nuk mund të lëvizte, nuk përputhen me aktet e administruara në dosje dhe bien ndesh me prokurën e nënshkruar prej tij në vitin 2012 (4 vite pas blerjes prej tij të automjetit), ku rezulton se i janë dhënë tagra të plota subjektit të rivlerësimit, përfshirë dhe përdorimin e këtij automjeti për nevoja pune dhe familjare brenda dhe jashtë Shqipërisë.

48.7. Sa më sipër, vërehet se edhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit rezulton se ka patur në përdorim për rreth 4 vite një automjet pa leje qarkullimi, të parregjistruar në DPSHTRR, si dhe pa paguar detyrimet doganore.

49. Në rastin konkret, marrë në konsideratë dhe gjetjet e listuara më lart, referuar verifikimit të rrethanave që ndikojnë në cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, pas vlerësimit tërësor të procedurave në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vjen në përfundimin se, për nga rëndësia e tyre, shkeljet e lejuara gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, problematikat e përsëritura e të kthyera në një model pune gjatë viteve të ushtrimit të detyrës, ndikimi në veprimtarinë shtetërore i aktivitetit profesional të subjektit të rivlerësimit, rëndësia e gjetjeve të tjera, që përfaqësojnë mënyrën e të vepruarit të subjektit të rivlerësimit edhe jashtë aktivitetit profesional, parë kjo në kuadër të rëndësisë së perceptimit publik përgjatë ushtrimit të detyrës së magjistratit, duket se në tërësi kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për këto shkaqe, subjekti i rivlerësimit duhet të konsiderohet i papërshtatshëm për vijueshmërinë e detyrës, edhe në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

50. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale dhe me sjelljet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë;

51. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

⁴⁵ Referohuni pikës 7.15 të vendimit të Komisionit.

52. Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërmbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 4 dhe 5, të këtij ligji;

Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 698, datë 15.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gjergji Tako.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA